



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVA  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT  
MUNICIPALITY OF DEÇAN  
OPSTINA DEÇAN



**Drejtoria e Arsimit**

**10.08.2026**

**Nr.07-Zyrtarisht**

Në bazë Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr. 02/2016, neni 11 dhe kërkesave të SHML-së të datës: 22.07.2026, me nr. Prot.14682/07,si dhe IAAP- së të datës 10.07.2026, me numër prot. , Drejtoria Komunale e Arsimit në Deçan shpallë këtë:

**FTESË PËR OFERTË**

Për organizimin e Ekskursioni në Shqipëri, më maturantë të dy shkollave të mesme të larta:

1. SHML- Gjinnazi - "Vëllezërit Frashëri" në Deçan;
2. IAAP - "Tafil Kasumaj" në Deçan.

**Ekskursioni do të jetë pesë ditë ( katër netë akomodimi).**

**Agjensioni duhet të plotësojë këto parakushte:**

1. Të ketë licencë valide;
2. Të ketë kontroll teknik të autobusëve sipas procedurave ligjore;
3. Të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e nxënësve;
4. Autobusët të jenë komfor dhe më klimë;
5. Të mos ketë referenca negative;
6. Të ofrojë dëshmi për shëndetin fizikë dhe mendor të ngasësve të autobusëve;
7. Të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit dhe dëshmi (certifikatë pune si dhe diplomë të mjekut të angazhuar, të mos jetë i/e pensionuar
8. Agjensioni është i obliguar të zbatojë itinerarin e caktuar të ekskursionit;
9. Të posedojë dokumentacionin (licencë), e agjencionit të akreditimit të ushqimeve për vendqëndrimin e nxënësve;
10. T'i mbulojë shpenzimet e kujdestarëve të klasave, si dhe shpenzimet e vizitave të nxënësve në monumente historike;
11. Ti mbulojë shpenzimet për një zyrtarë të DKA-së ( Monitorues gjatë gjithë kohës, për pesë ditë radhazi, për dy shkollat, me te gjitha shërbimet ne hotel ( **All- Inclusive**)
12. Ti mbulojë shpenzimet për një përfaqësues të Këshillit të Prindërve, ne hotel ( **All- Inclusive**)
13. Ekskursioni do të zhvillohet në shtetin shqiptar, pikë qëndrimi do të jetë Durrësi;
14. Do të ofrohen tre shujta ditore (mëngjes, drekë dhe darkë);
15. Do të vizitohen këto qendra: Shkodra, Lezha, Tirana, Kruja, dhe Berati – (Gjinnazi);
16. Do të vizitohen këto qendra: Kruja, Durrësi, Vlora, Tirana, – (IAAP).

Ofertuesi ka për obligim të përcaktojë se për cilën shkollë oferton.

Oferta do të shqyrtohen për secilën shkollë në mënyrë të veçantë, pa u ndikuar nga ofertat e shkollave tjera, objekte të kësaj oferte.

Kriteret për përzgjedhjen e kompanisë janë të përcaktuara në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr. 02/2016.

Kompanitë fituese, do të monitorohen nga DKA-ja.

**Afati i ofertës është 7 ditë, nga dita e shpalljes.**

Ofertat protokollohet në zyrën pritëse, (zarfa e mbyllur), pa u protokolluar dokumentacioni, pastaj dorëzohen në zarfe të mbyllur (personalisht) në zyrën e DKA-së në katin e parë nr.17".

**Data e fundit e aplikimit, 18.08.2026**

**Hapja e ofertave bëhet më datë:18.08.2026 ( ditë e Martë ora 17:00), në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Deçan, në zyrën numër 10-të, ne prani të komisionit dhe ofertuesve.**

